

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2021**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2021

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit të sistemit bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹) Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njeditore	R/REPO njejavore	R/REPO >1jave <3muaj	REPO Njeditore
7-tetor-21		24.27		
14-tetor-21		33.08		
21-tetor-21		36.46		
24-tetor-21			6.43	
28-tetor-21		24.80		
4-nentor-21		25.14		
11-nentor-21		21.07		
18-nentor-21		24.51		
24-nentor-21			5.86	
25-nentor-21		29.19		
2-dhjetor-21		31.58		
2-dhjetor-21		25.40		
9-dhjetor-21		20.59		
16-dhjetor-21		21.14		
23-dhjetor-21		27.37		
24-dhjetor-21			1.90	
30-dhjetor-21		16.53		

Në tremujorin e katërt të vitit 2021, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacione të tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë, ka qenë 42.4 mld lekë kundrejt 41.9 mld lekë në 3-mujorin e mëparshëm dhe 39.3 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë vitit

2021, mesatarja e likuiditetit të injektuar ka qenë 38.1 miliardë lekë kundrejt 35.1 miliardë lekë në vitin 2020.

Kërkesa e bankave për likuiditet në operacionet e Bankës së Shqipërisë është luhatur gjatë periudhës në bandë të ngjashme me 3-mujorin e mëparshëm në 35.3-53.5 mld lekë, duke shënuar nivelet maksimale në fund të muajit tetor dhe ato minimale në javën e parafundit të muajit dhjetor.

Paraja në qarkullim është rritur më tej me 5.5 mld lekë gjatë periudhës duke ruajtur prirjen rritëse të qëndrueshme të viteve të fundit.

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.


Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor kanë ndikuar në rritjen e likuiditetit të sistemit bankar me 3.13 miliardë lekë, e përqëndruar në pjesën e dytë të muajit dhjetor. Gjatë vitit 2021, injektimet e Bankës së Shqipërisë nëpërmjet blerjeve të valutës nga bankat e nivelit të dytë kanë qenë 14.30 miliardë lekë. Ulja e portofolit me 1.4 miliardë lekë ka pasur ndikim të lehtë në rritjen e mungesës.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 26.71 mld lekë ose 63.0% kundrejt 63.40% në 3-mujorin e mëparshëm.

Në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare (KZKPM), prej javës së dytë të muajit mars 2020, Banka e Shqipërisë ka ndryshuar formën e ankandit nga “ankand me shumë të fiksuar” në “ankand me çmim uniform”, ku bankat mund të marrin hua shuma të pakufizuara me normë interesi të njëjtë me normën bazë. Vendimi ka synuar uljen e pasigurisë në sistemin bankar për gjendjen e likuiditetit në çdo bankë.

Në vijim të komunikimit në konferencën për shtyp pas mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës së datës 3 nëntor 2021, për ndërprerjen e operacioneve injektuese me “çmim uniform” gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2022, në datën 23 nëntor 2021, janë lajmëruar bankat e nivelit të dytë se, operacionet injektuese javore do të riktheheshin në formatin e tyre të zakonshëm me “shumë të kufizuar” prej ankandit të datës 23 shkurt 2022 dhe me datë të shkëmbimit të fondeve në fillim të RD të periudhës në 24 shkurt 2022.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2021 (me vlerë nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Sistemi bankar e ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH në mënyrë të vazhdueshme për mesatarisht 6.53 mld lekë kundrejt 6.30 mld lekë në 3-mujorin e mëparshëm dhe 6.60 mld lekë në gjithë vitin 2021.

Instrumenti i kredisë njëditore nuk është përdorur në asnjë rast.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2021, portofoli i Bankës së Shqipërisë ka rënë me 1.4 mld lekë në pjesën e poshtme të bandës së synuar prej 65.60-69.60 miliardë lekë. Operacionet e Bankës së Shqipërisë synonin mbajtjen e portofolit në nivele të pandryshuara gjatë 3-mujorit, por pjesëmarrja e ulët e bankave në ankandet e blerjes së letrave me vlerë bëri që vlera e portofolit të zvogëlohet. Aktualisht, vlera e portofolit është në nivelin prej 65.63 mld lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pas rritjes së portofolit në 6 muajt e parë të vitit 2020, në 18 muajt e fundit, luhatjet e portofolit të Bankës së Shqipërisë kanë qenë minimale.

1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës nuk ka pasur operacione rregulluese.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2021

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të datës 22 dhjetor 2020 për blerjet gjatë vitit 2021, dhe kalendarin e publikuar në të njëjtën datë, në 3-mujorin e katërt të vitit 2021, janë zhvilluar 4 ankande, në të cilat janë blerë 25.80 milionë euro kundrejt 34.20 milionë euro në 3-mujorin e mëparshëm dhe 40.70 milionë euro të blera në 4 ankandet e 3-mujorit të dytë. Shuma totale e blerjeve në vitin 2021 është rritur në 116.8 milionë euro.

Kalendari i ndërhyrjeve në treg

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2021		
	Data	Shuma Raundi I (në euro)
1	19/02/2021	4-6 mln
2	19/03/2021	4-6 mln
3	15/04/2021	4-6 mln
4	14/05/2021	4-6 mln
5	07/06/2021	4-6 mln
6	21/06/2021	4-6 mln
7	09/07/2021	4-6 mln
8	23/07/2021	4-6 mln
9	06/08/2021	4-6 mln
10	20/08/2021	4-6 mln
11	18/10/2021	4-6 mln
12	18/11/2021	4-6 mln
13	03/12/2021	4-6 mln
14	20/12/2021	4-6 mln

* Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.

Në lidhjen e mëposhtme mund të gjeni një informacion të përmbledhur mbi historikun dhe rezultatet e ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankës_së_Shqipërisë/Ndërhyrjet_në_tregun_valutor/

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2021, fillimisht, MFE ka ulur shumën e marrëveshjeve SWAP të pamaturuara nga 35 mld lekë në më pak se 20 mld lekë, por me miratimin e limitit të ri në fund të vitit, marrëveshjet SWAP të pamaturuara janë rritur në 35.78 mld lekë dhe të shpërndara deri në fund të vitit 2022.

Gjatë 3-mujorit, Banka e Shqipërisë ka blerë 6.23 milionë euro nga programi IPA i MFE dhe 0.36 milionë euro nga IBRD.